

Këshillimoret

Disa këshillimore iu përgjigjen pyetjeve të përgjithshme, ndërsa të tjera janë të specializuara në tema ose fusha të caktuara të jetës. Oferta ndryshon në varësi të zonës së banimit. Si rregull, këshillimi i parë është falas, shpesh edhe këshillime të tjera. Disa qendra ofrojnë këshillime edhe në gjuhë të huaja.

Qendra e informacionit për integrimin INFI

INFI është në dispozicion të migrantëve për informacione të shkurtra mbi çështjet e përditshme.

Përveç kësaj, INFI ofron informacion për administratën, strukturat zyrtare, organizatat dhe institucionet e specializuara.

Keni një pyetje?

Na kontaktoni me e-mail në **chancengleichheit@ar.ch** ose me telefon në **071 353 64 26**.

Administrata e komunës / administrata e qytetit

Për shumë situata, administrata e vendbanimit (administrata komunale, Gemeindeverwaltung / administrata e qytetit, Stadtverwaltung) është vend i parë i mirë për t'u drejtuar. Punonjësit mund të përgjigjen në pyetje direkte ose të rekomandojnë një qendër të përshtatshme këshilluese. Të gjitha komunat në Kantonin Appenzell Ausserrhoden kanë një faqe interneti të tyre. Atje mund të gjenden të dhënat e kontaktit, oraret e punës dhe informata të tjera, ndonjëherë edhe listat me ofertat për këshillim dhe integrim në rajon.

Këshillim juridik falas

Kantoni mundëson këshillime juridike falas. Këto ofrojnë këshillim falas për të gjithë banorët për çështje juridike (këshillime të shkurtra). Orët e konsultimeve zhvillohen në intervale të rregullta. Datat mund të gjenden në internet ose të pyeten në komunën e banimit. Nuk pranohen pyetje telefonike ose me shkrim, duhet të paraqiteni personalisht.

Përveç kësaj, institucione të tjera ofrojnë gjithashtu këshilla juridike, zakonisht falas, për fusha të ndryshme (punësim, banim, martesë/familje), për shembull sindikatat. Nëse konsultimi kërkon shumë kohë, zakonisht ka kosto të lidhura.

Advokatur + Notariat La Region, Heiden, Teufen, Herisau, Appenzell, T: +41 71 622 03 03

Grand & Nisple Rechtsanwälte, Oberer Graben 26, 9000 St. Gallen, T: +41 71 222 40 33

Diskriminimi racor

Qendra e këshillimit HEKS kundër racizmit dhe diskriminimit në St. Gallen është një shërbim i pavarur këshillimi për viktimat e diskriminimit racor.

Këshillimi është konfidencial dhe falas për banorët e kantonit Appenzell Ausserrhoden. Janë të mundshme si takimet personale ashtu edhe këshillimet telefonike.

find help Appenzell Ausserrhoden (gjej ndihmë)

Shëndetësia dhe çështjet sociale - Ndihma e lehtë për t'u gjetur

Këtu, banorët e kantonit Appenzell Ausserrhoden mund të gjejnë oferta këshillimi dhe mbështetjeje në fushat e shëndetësisë dhe çështjeve sociale.

Këshillë: Gjatë kërkimit, shkruani vendbanimin tuaj për të gjetur ofertat e institucioneve përgjegjëse për ju.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-ar.ch/sq/emergjencat-dhe-keshillimore/keshillimore